



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 30.3.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi-OSBE; Lumnije Murati- Zyra e Presidentes së Kosovës; Krenare Loxhaj- QKSS; Visar Rushiti-GAP; Arbana Pireva-praktikante.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 27.2.2015 dhe 11.3.2015;
3. Realizimi i planit të punës për tremujorin e parë 2015;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 27.2.2015 dhe 11.3.2015

Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 27.2.2015 dhe 11.3.2015, u miratuan me vërejtje.

Vërejtja u bë nga ana e z.Rexhep Selimi, për mospërfshirjen e emrit në listën e pjesëmarrësve në mbledhje, i cili u konsiderua gabim teknik.

3. Realizimi i planit të punës për tremujorin e parë 2015

Kryetari- Për tremujorin e parë janë shqyrtuar dhe miratuar Projektligji për pjesëmarrje në konflikte jashtë territorit të vendit, i cili tashmë është nënshkruar nga Presidentja, në raportim ka qenë ministri i Ministrisë së FSK-së dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati, raporti vjetor i FSK-së.

Tani jemi në pritje të pakos ligjore për transformimin FSK-së. Gjithashtu, janë krijuar dy grupe punuese, njëri për mbikëqyrjen e Ligjit për policinë, po ashtu janë realizuar vizita në terren, siç ka qenë vizita në Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Istog. Gjithashtu, janë realizuar disa vizita jashtë vendit, takime me organizata që merren me sektorin e sigurisë, ku rëndësi i është kushtuar Projektligjit për komisionarin e FSK-së dhe PK-së.

Më tutje theksoi se për tremujorin e parë në raportim ka qenë edhe ministri i Punëve të Brendshme, drejtori i Përgjithshëm i Policisë, ku nga ana e Komisionit është dhënë përkrahje. Konsideroi se në këtë tremujor, është bërë një punë e mirë dhe duhet të vazhdojmë tutje me këtë rrjedhë dhe falënderoi për bashkëpunimin. Fjalë ua dha anëtarëve të Komisionit.

Rexhep Selimi- Theksoi se përveç aktiviteteve që u listuan nga ana e kryetarit, të shtohet edhe një aktivitet, ku z.Selimi ka qenë pjesëmarrës si anëtar i Komisionit, në konferencën e organizuar nga BIRN, me temën: “Afrimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare të bashkëpunimit policor”.

Nuredin Ibishi- Vlerësoi se do të ishte mirë që nga ana e Komisionit, të bëhet një lloj trysnie për Strategjinë Legjislative, pra që mos të pritët gjatë, pasi po bëhen vonesa dhe më pas mund të krijojë ngarkesë të agjendës për më vonë. Ndërsa, lidhur me Inspektoratin Policor të Kosovës, ku ka vonesa në raportim, edhe për këtë duhet të kërkojmë të raportojnë me kohë.

Zafir Berisha- Nga praktika e kaluar, raportet janë bërë me shkrim dhe më të detajuara, në mënyrë që të mbesin në arkiv dhe që të dihet saktë për aktivitet e realizuara nga ana e anëtarëve të Komisionit.

Kryetari- Për tremujorin e ardhshëm do të vazhdohet me aktivitetet e radhës, do të realizohet vizitë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa sa i përket projektligjeve që vijnë nga Qeveria, jemi pak të kufizuar, pasi nuk ka diçka konkrete, por si Komision, do të jemi të gatshëm.

4. Të ndryshme

Kryetari- Njoftoi për kërkesën e cila i është drejtuar nga ana e Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës, e cila i është drejtuar edhe Kryeministrit dhe institucioneve të tjera përgjegjëse.

Si Komision, propozoj që t'i drejtohem Ministrit të Punëve të Brendshme me një shkresë, në mënyrë që të trajtohet Vendimi i ish-Kryeministrit të Qeverisë së kaluar, ku këtë mekanizëm e bartë nga pushteti lokal dhe e integron në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent. Në kërkesën e tyre shprehen shqetësimet, si: koeficienti i ulët, gradat, nuk ka sistem të hierarkisë së komandës etj.

Nga ana e tyre, është kërkuar që të rregullohet statusi juridik, si dhe të nxirret ligj i veçantë për zjarrfikësit, të definohen kompetencat menaxhuese, përmirësimi i kushteve të punës, sigurimi i pajisjeve dhe mjeteve të punës, kompensimi i ndërrimit të natës, festat shtetërore dhe puna jashtë orarit, nivelizimi i koeficientit, në të gjitha komunat e tjera dhe sigurimi i shujtës.

Kërkesa e tyre bazohet në Vendimin e ish-Kryeministrit të Republikës së Kosovës, pra të Qeverisë së kaluar, ku thotë që në vitin 2009 është bërë vendimi, ku të gjitha njësitë tërhiqen nga niveli lokal dhe barten në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Pra, nga kjo kuptohet që në një pjesë të Kosovës janë tërhequr dhe në një pjesë jo, dhe nga ana e tyre kërkohet që përmes Komisionit, të ndikohet në zgjidhjen e kësaj situate. Për këtë arsye, propozoi që t'i shkruhet një letër ministrit të MPB-së, për t'i kërkuar që të trajtojë më seriozisht këtë problematikë.

Rexhep Selimi- Kjo ka qenë njëra ndër temat, e cila është trajtuar edhe në legjislaturën e kaluar në Komision dhe në Kuvend, por problematika e tyre nuk është e kufizuar vetëm tek Ministria e Punëve të Brendshme dhe vetëm me letër, drejtuar ministrit, konsideroi se nuk do të zgjidhet problemi.

Mënyra e pagesës dhe e menaxhimit, janë të ndara si hierarki dhe se nga Qeveria e kaluar është premtuar që do të jenë të organizuar, jo në nivel komunash, por në nivel qendror. Kjo çështje mbetet problem kompleks dhe nuk do të zgjidhet vetëm me një protagonist.

Gjithashtu, konsideroi se edhe në Ligjin për buxhet është ky problem, pasi linjat buxhetore janë të komplikuar se si bëhet pagesa e tyre, pasi pagesa e tyre bëhet përmes buxheteve komunale, prandaj ka diferenca në paga nga një komunë në tjetrën.

Prandaj, përveç ministrit, do të ishte mirë që edhe aktorët e tjerë të përfshihen në takim në Komision, në mënyrë që të zgjidhet kjo çështje. Për këtë, mbështes idenë për t'i dërguar letër ministrit, dhe përveç kësaj, si Komision, të kemi një dinamikë më aktive, në mënyrë që të zgjidhet kjo çështje, prandaj konsideroj se një takim i përbashkët i të gjithë aktorëve, do të ishte i dobishëm.

Fadil Demaku- Vlerësoj se për këtë çështje do të ishte mirë që secili nga anëtarët të kenë kërkesën e dërguar nga ana e Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës, për të parë kërkesat e tyre dhe të japim kontributin si deputet. Duke ditur rolin dhe rëndësinë e këtij shërbimi, duhet të marrim seriozisht dhe ta trajtojmë edhe në disa komuna të tjera, siç është ajo e Drenasit. Nga ana e zjarrfikësve është shprehur shqetësimi për kushtet në të cilat ata punojnë, prandaj duhet të ndërjegjësohemi që çështja e zjarrfikësve, të ngrihet në nivel më të lartë.

Zafir Berisha- Kjo problematikë i shqetëson të gjithë, sepse edhe në Komunën e Prizrenit ka vështirësi në funksionimin e tyre. Kjo çështje nuk zgjidhet me udhëzim administrativ.

Qerim Bajrami- Për këtë çështje, duhet të gjendet zgjidhje institucionale, duke pasur parasysh që gjendja në njësinë e zjarrfikësve, është e palakmueshme. Ndërsa, në Komunën e Prizrenit, numri i të punësuarave është i vogël dhe se njësitë aktuale nuk janë aktive. Duhet të bëjmë përpjekje për rritjen e buxhetit, ndërsa për Ligjin për zjarrfikësit, të gjemë zgjidhje institucionale.

Kryetari- Shqetësimet që shprehin ata, moszbatimi i Ligjit të punës, ligjit për zjarrfikës, ligjit për shërbyesit civilë, ligji për pagat e shërbyesve civilë, Rregullorja nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe shtesat tjera, si dhe moszbatimi i kontratave të punës, ka shkaktuar pakënaqësi. Buxheti i miratuar tashmë i ka paraparë vijat buxhetore, por gjatë procesit të rishikimit, në muajin qershor, të shqyrtohet kjo çështje. Para një jave, unë si deputet, i kam parashtruar pyetje ministrit të Punëve të Brendshme, pikërisht për këto arsye. Prandaj, do të propozoja që t'i takojmë të gjithë aktorët përgjegjës, në mënyrë që të gjejmë një zgjidhje. Problemi i tillë është në njëmbëdhjetë komuna të Kosovës.

Fadil Demaku- Theksoi se çështja e zjarrfikësve është diskutuar edhe më herët në Komision dhe nuk është vetëm kjo shkresë që i është drejtuar nga ana e tyre, që të mobilizojë Komisionin. E rëndësishme është krijimi i bazës ligjore për këtë kategori, në mënyrë që statusi i tyre të jetë i rregulluar dhe mos të mendojmë vetëm për zgjidhje ad-hoc.

Rexhep Selimi- Me çështjen e zjarrfikësve jemi marrë edhe vitin e kaluar. Gjendja aktuale edhe atëherë edhe tani është me shumë probleme. Njëri prej problemeve kryesore, nuk ka qenë menaxhimi, por ka qenë edhe nafta për makineritë intervenuese. Problem që duhet të zgjidhet urgjentisht është linja buxhetore e veçantë për zjarrfikësit. Po ashtu, kërkoj që të kemi një ligj të veçantë për zjarrfikësit, që ne si Komision të marrim një iniciativë për hartimin e një ligji, nëse ky ligj do të jetë i gatshëm deri në hartimin e buxhetit të vitit 2016, kishte për të qenë në një kohë optimale, duke qenë si një zgjidhje më adekuate.

Ganimete Musliu- Propozoj që të përcaktohet një grup punues, i cili do të punonte dhe të përgatiste terrenin që shumë shpejt të marrim iniciativën, ndoshta edhe për ligjin e veçantë të zjarrfikësve. E dimë rolin dhe rëndësinë që ka ky institucion, prandaj nuk është mirë që të lihet në këtë mënyrë. Mungesa e linjës buxhetore do të jetë problem permanent, me të cilin do të ballafaqohen zjarrfikësit në përgjithësi, e sidomos në komunat e vogla, kur dihet që buxheti i tyre është më i kufizuar.

Kryetari- Nëse dakordohemi, mund të krijojmë një grup punues për hartimin e ligjit për zjarrfikës, por duhet të ceket, që brenda këtij ligji, duhet të hyjnë edhe emergjencat civile, por paraprakisht, si Komision, t'i drejtohem Qeverisë me një shkresë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, ministrit të Financave, që ta trajtojnë këtë kategori, për shkak se ka vendime të mjaftueshme ligjore, ka hapësirë të mjaftueshme juridike për të zgjidhur këtë problem.

Rexhep Selimi- Propozoj që një grup punues i përkohshëm, të merret me vlerësimin e situatës, mbi të cilën merret iniciativa ligjore, pastaj të vijë në Komision, me një raport sesi është situata, më pas, me referim të këtij grupi punues, të fillohet iniciativa ligjore.

Kryetari- Jemi dakord për këtë, edhe pse nga ana e tyre është shprehur gatishmëria për të raportuar në Komision dhe ne mund t'i vizitojmë për të parë gjendjen reale.

Zafir Berisha- Propozoj që para se të krijohet grupi punues, personat përgjegjës që kanë parashtruar kërkesën, të takohen me Komisionin, në mënyrë që të njihemi më afër me problematikën e tyre.

Kryetari- Nga diskutimet që patëm, vijmë në përfundimin që, fillimisht të bëjmë një takim me Sindikatën e Zjarrfikësve të Kosovës, dhe pas takimit, vendosim për drejtimin e një shkrese ministrit ose formimin e grupit punues për hartimin e ligjit për zjarrfikësit.

Rexhep Selimi- E rëndësishme është të konstatohen dy gjëra, të shihet gjendja reale dhe infrastruktura ligjore, që do duhej të plotësohet, dhe më pas të merret vendim sesi ta procedojmë.

Kryetari konstatoi se pas diskutimeve dhe propozimeve, të caktohet takimi me përfaqësuesit e Sindikatës së Zjarrfikësve të Kosovës, ku si datë e mundshme të propozohet dita e premte, datë 3 prill, ku i ftuar të jetë edhe drejtori i Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave, ku më pas mund të bëjmë edhe vizita.

Po ashtu, njoftoi për tryezën e rrumbullakët, që do të organizohet nga DCAF-i, më 1 prill, ku të ftuar janë të gjithë anëtarët e Komisionit.

Nëse nuk keni çështje për të diskutuar, me këtë pikë e konsideroj të mbyllur takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj